E takova Ibrahimin natën kur u ngrita për në Isra, e në atë rast më tha: "O Muhamed, përshëndete umetin tënd me selam nga ana ime dhe informoji se Xheneti ka tokë të mirë, ujë të ëmbël

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: "E takova Ibrahimin natën kur u ngrita për në Isra, e në atë rast më tha: "O Muhamed, përshëndete umetin tënd me selam nga ana ime dhe informoji se Xheneti ka tokë të mirë, ujë të ëmbël, dhe se ajo është e sheshtë dhe e rrafshuar, dhe se mbjelljet e tij janë: subhanallah, elhamdulillah, la ilahe il-lallah dhe Allahu ekber (I Lartësuar është Allahu, falënderimi i takon Allahut, s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut dhe Allahu është më i Madhi)."

[Hasen bi shevahidihi] [Transmeton Tirmidhiu]

Profeti në këtë hadith na tregon se e takoi Ibrahimin (alejhi selam), mikun e ngushtë të Allahut, natën e Israsë dhe Miraxhit, i cili i tha: "O Muhamed, përshëndete umetin tënd me selam nga ana ime dhe informoji se Xheneti ka tokë të mirë, ujë të ëmbël e pa kripë, dhe se Xheneti është i gjerë e i sheshtë, pa pemë, dhe mbjelljet e tij janë fjalët e mira, dhe se ato janë fjalë të qëndrueshme dhe të mira: subhanallah, elhamdulillah, la ilahe il-lallah dhe Allahu ekber. Sa herë që muslimani i thotë dhe i përsërit këto fjalë, për secilën herë do t'i mbillet një pemë në Xhenet."

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3791